

Nr. Prot. 26
Tiranë, më 14.04.2021

Nr. Prot. 164
Tiranë, më 14.04.2021

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

MIDIS

ORGANIZATËS PËR BASHKËPUNIM DHE SIGURI NË EUROPË - PREZENCA NË SHQIPËRI

dhe

GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

për

BASHKËRENDIMIN DHE BASHKËPUNIMIN NË ZBATIMIN E PROJEKTEVE DHE VEPRIMTARIVE QË SYNOJNË TË MBËSHTESIN GJYKATËN KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ky Memorandum Mirëkuptimi (në vijim: “Memorandum”) lidhet midis Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Prezencës në Shqipëri (në vijim: “Prezenca”), adresa e së cilës është: “Sheshi Italia,” 1010 Tiranë, Shqipëri

dhe

Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë (në vijim: “Gjykata Kushtetuese” adresa e të cilës është: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.26, Tiranë, Shqipëri

Në vijim, Prezenca dhe Gjykata Kushtetuese. referuar secilës si “Pala” dhe së bashku si “Palët”;

DUKE QENË SE Prezencës i është dhënë një mandat për të ndihmuar përpjekjet e Republikës së Shqipërisë në ngritjen e institucioneve efektive demokratike dhe promovimit të shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në përputhje me angazhimet, standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (në vijim OSBE);

DUKE QENË SE Gjykata Kushtetuese është një institucion kushtetues i pavarur që i nënshtrohet vetëm Kushtetutës, e cila, ndër të tjera, zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, vendos për çështje që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të funksionarëve të lartë shtetërorë, si dhe

vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo shkeljeje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, dhe kundër shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë;

DUKE QENË SE Prezenca synon të rrisë përpjekjet e saj të deritanishme për të dhënë mbështetje të natyrës teknike dhe në funksion të rritjes së kapaciteteve, duke i mundësuar Gjykatës Kushtetuese mjete dhe burime për përmirësimin e kapaciteteve të saja për gjykimin e çështjeve në përputhje me standardet ndërkombëtare të drejtësisë kushtetuese;

DUKE QENË SE Prezenca dhe Gjykata Kushtetuese synojnë të nënshkruajnë një Memorandum në mënyrë që të lehtësojnë bashkëpunimin dhe bashkërendimin mes Palëve për zbatimin e projekteve dhe veprimtarive,

PËR SA PËRMENDUR, TANI, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e veprimit të Memorandumit të Mirëkuptimit

1. Ky Memorandum krijon një kornizë për bashkëpunimin dhe bashkërendimin midis Prezencës dhe Gjykatës Kushtetuese në lidhje me zbatimin e projekteve dhe veprimtarive që synojnë të ofrojnë ndihmë për ndërtimin e kapaciteteve dhe mbështetje teknike me qëllim pajisjen e Gjykatës Kushtetuese me mjete dhe burime për përmirësimin e kapaciteteve të saj për gjykimin e çështjeve në përputhje me standardet ndërkombëtare të drejtësisë kushtetuese, siç parashikohet në Shtojcën e këtij Memorandumi.

2. Ky Memorandum synon vetëm të parashtrojë disa koncepte të caktuara të Palëve në lidhje me termat dhe kushtet që do të dakordësohen midis Prezencës dhe Gjykatës Kushtetuese në Shtojcën e këtij Memorandumi, ku rregullohet në mënyrë më të hollësishme bashkëpunimi në fushat e caktuara të veprimit.

Neni 2

Natyra jo-detyruese e Memorandumit

1. Asgjë në këtë MM nuk krijon detyrime ligjore ose financiare për Palët. Për ndonjë detyrim ligjor ose financiar që mund të lindë nga ndonjë nismë që përmendet në këtë Memorandum, do të lidhet një marrëveshje e veçantë, përpara se një veprimtari e tillë të ndërmerret.

Neni 3

Zbatimi

1. Palët do të bashkëpunojnë ngushtë për realizimin e projekteve dhe veprimtarive të planifikuara në kuadër të këtij Memorandumi.

2. Palët e kuptojnë dhe bien dakord që zbatimi i këtij Memorandumi prej secilës Palë do t'i nënshtrohet rregulloreve, rregullave, udhëzimeve, politikave dhe procedurave përkatëse të asaj Pale, si dhe vendimeve të organeve të saj drejtuese.

3. Bashkëpunimi i palëve në kuadër të këtij Memorandumi nuk do të jetë mbi baza ekskluzive. Prandaj, ky Memorandum në asnjë mënyrë nuk krijon kufizime për marrjen pjesë të asnjërës prej Palëve në dispozita ose marrëveshje të ngjashme, përfshirë edhe kërkimin e financimeve për projekte, ndër të tjera, pranë organizatave të tjera ndërqeveritare, agjencive publike dhe organizatave jofitimprurëse.

Neni 4 **Roli i Prezencës**

1. Në varësi të dispozitave të këtij Memorandumi dhe fondeve në dispozicion, Prezenca synon të:

- a) Zbatojë projekte dhe veprimtari siç përcaktohet në Nenin 1 të këtij Memorandumi;
- b) Mbulojë me buxhetin e akorduar Prezencës shpenzimet operationale, administrative dhe kosto të tjera për hartimin dhe zbatimin e projekteve dhe veprimtarive, siç përcaktohet në Nenin 1 të këtij Memorandumi. Fondet do të shpenzohen në përputhje me rregullat dhe rregulloret përkatëse të OSBE-së;
- c) Caktojë një person kontakti për secilin nga projektet dhe veprimtaritë, siç përmenden në Nenin 1 të këtij Memorandumi, për të siguruar zbatimin pa pengesa dhe rrugën e saktë të komunikimit dhe informacionit;
- d) Kontribuojë në natyrë për projektet dhe veprimtaritë siç përmenden në Nenin 1 të këtij Memorandumi përmes stafit dhe ekspertëve të saj të brendshëm, si dhe me lehtësirat, logjistikën, prokurimin dhe mundësitë e administrimit financiar të zyrës së saj;
- e) Marrë të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin efektiv dhe zbatimin e projekteve dhe veprimtarive siç përmenden në Nenin 1 të këtij Memorandumi, duke përfshirë dhënien e informacionit të saktë dhe në kohë për vështirësitë e mundshme që mund të ndeshen gjatë fazës së zbatimit;
- f) Monitorojë zbatimin e duhur të projekteve dhe veprimtarive siç përmenden në Nenin 1 të këtij Memorandumi dhe të raportojë për zbatimin e tyre tek shtetet anëtare të OSBE dhe/ose donatorët dhe palët e interesuara, në përputhje me rregullat dhe rregulloret përkatëse të OSBE-së.

Neni 5 **Roli i Gjykatës Kushtetuese**

1. Në varësi të dispozitave të këtij Memorandumi, Gjykata Kushtetuese synon të:

- a) Caktojë një person kontakti për secilin nga projektet dhe veprimtaritë që përmenden në Nenin 1 të këtij Memorandumi për të siguruar zbatimin pa pengesa dhe rrugën e saktë të komunikimit dhe informacionit;
- b) Kontribuojë dhe bashkëpunojë në natyrë përmes stafit të brendshëm apo ekspertëve të jashtëm, në zbatimin e projekteve dhe veprimtarive që përmenden në Nenin 1 të këtij Memorandumi;
- c) Lehtësojë kontaktet me stafin e Gjykatës që do të përfshihen në zbatimin e projekteve dhe veprimtarive që përmenden në Nenin 1 të këtij Memorandumi;
- d) Marrë pjesë në Grupe Pune/Takime të Palëve të Interesuara/Konferenca të organizuara për veprimtaritë e projektit;
- e) Japë informacion të saktë dhe në kohë për vështirësitë e mundshme që mund të ndeshen gjatë zbatimit;

- f) Ndërmarrë të gjitha masat, duke përfshirë dhe aksesin për informacionet përkatëse, që kërkohen për garantimin e zbatimit efektiv të projekteve dhe veprimtarive që përmenden në Nenin 1 të këtij Memorandumi;

Neni 6 **Konfidencialiteti**

1. Secila palë merr përsipër se nuk do të përdorë, zbulojë ose komunikojë në asnjë kohë me asnjë person, përveç përfaqësuesve të saj profesionalë ose këshilltarëve ose siç mund të kërkohet nga ligji ose ndonjë autoritet ligjor apo rregullator, asnjë informacion konfidencial në lidhje me punët ose çështjet e palës tjetër e cila mund të ketë ardhur në dijeninë e saj si rezultat i nënshkrimit të këtij Memorandumi.
2. Për qëllim të këtij Memorandumi, me informacion konfidencial kuptohet çdo informacion, i cili jepet ose përhapet, drejtpërdrejt ose indirekt dhe që në kohën e përhapjes ose dhënies së tij, është identifikuar si konfidencial.

Neni 7 **Përgjegjësitë dhe zhdëmtimi**

1. Palët nuk do të marrin përsipër përgjegjësi për pretendimet e palëve të treta për dëme që lindin nga zbatimi i këtij Memorandumi përmes një pale tjetër.
2. Palët do të marrin masa që zyrtarët e tyre, agjentët dhe personat që kryejnë shërbime për Prezencën, si dhe çdo person tjetër nën varësinë e Palëve për qëllimin e zbatimit të këtij Memorandumi, të shmangin çdo veprim që mund të ndikojë negativisht në imazhin dhe statusin e OSBE-së ose të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 8 **Vizibiliteti**

1. Kontributi i secilës Palë për zbatimin e projekteve dhe veprimtarive që përmenden në Nenin 1 të këtij Memorandumi do të evidentohet siç duhet në çdo material të shtypur, njoftime për shtyp, fjalime, ngjarje publike apo çdo material tjetër që përgatitet në lidhje me projektet dhe veprimtaritë, në respekt të plotë të rregulloreve, rregullave, udhëzimeve dhe procedurave përkatëse.
2. Asnjëra Palë nuk do të përdorë emrin, stemën dhe vulën zyrtare të Palës tjetër ose shkurtime të emrit të Palës tjetër, në çfarëdolloj forme ose mënyre, pa kërkuar më parë autorizim me shkrim nga Pala tjetër.

Neni 9 **Të drejtat e pronësisë intelektuale**

1. Të gjitha të drejtat, titulli dhe interesi për materialet e prodhuara, shpikura ose zhvilluara në zbatim të këtij Memorandumi, duke përfshirë pa kufizim të gjitha të drejtat e autorit dhe

patentat, do të gëzohen ekskluzivisht nga OSBE-ja, e cila mund të japë një licensë të pakufizuar, jo ekskluzive dhe pa pagesë për Gjykatën Kushtetuese për përdorimin, riprodhimin, botimin, përkthimin dhe shpërndarjen e tyre dhe jo për qëllime përfitimi, në një mënyrë të përshtatshme dhe siç parashikohet nga projektet dhe veprimtaritë që përmenden në Nenin 1 të këtij Memorandumi.

2. Për veprimtari të caktuara, të drejtat e pronësisë intelektuale mund të rregullohen nëpërmjet marrëveshjes mes palëve në kuadër të çdo projekti siç përmendet në Nenin 1 të këtij Memorandumi.

Neni 10

Mospërfitimi nga ana e zyrtarëve

1. Palët nuk do t'i japin asnjë zyrtari të Palës tjetër ndonjë përfitim të drejtpërdrejtë, ose të tërthortë, apo ndonjë trajtim preferencial në kuadrin e këtij Memorandumi. Çdo shkelje e kësaj dispozite do të përbëjë shkelje thelbësore të këtij Memorandumi.

Neni 11

Komunikimi

1. Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e projektit do të adresohen si më poshtë:

Për Prezencën:

Drejtuues i Projektit:

Ama Kraja

Adresa: Sheshi "Italia",

MAK Albania Tirana Hotel

Tiranë, Shqipëri

Telefon: +355 694010096

E-mail: Ama.Kraja@osce.org

Për Gjykatën Kushtetuese:

Sekretar i Përgjithshëm:

Eugen Papandile

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët

e Kombit", Nr.26

Tiranë, Shqipëri

Telefon: +355 692053334

E-mail: eugen.papandile@gjk.gov.al

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët do të bëjnë çdo përpjekje të mundshme për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga Memorandumi.

2. Për veprimtari të caktuara mënyra e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mund të bëhet nëpërmjet marrëveshjes në kuadër të çdo projekti mes palëve siç parashikuar në nenin 1 të këtij Memorandumi dhe shtojcës së tij.

Neni 13
Privilegjet dhe imunitetet

1. Asgjë në këtë Memorandum, ose lidhur me të, nuk do të interpretohet si heqje dorë, e shprehur ose e nënkuptuar, nga ndonjë prej privilegjeve dhe imuniteteve që gëzon OSBE-ja.

Neni 14
Ndryshimet

1. Dispozitat e këtij Memorandumi dhe Shtojcave të tij mund të ndryshohen me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve.
2. Konsultimet me qëllim ndryshimin e këtij Memorandumi mund të bëhen me kërkesë të njëjës prej Palëve.

Neni 15
Ndërprerja

1. Nëse një nga Palët mendon se Memorandumi nuk mund të zbatohet më gjatë në mënyrë efektive apo të përshtatshme, në tërësi ose pjesërisht, ajo do të konsultohet me Palën tjetër sa më shpejt të jetë e mundur për të gjetur zgjidhje të përshtatshme, si dhe mund ta përfundojë Memorandumi duke dërguar njoftim me shkrim.

Neni 16
Tërësia e Marrëveshjes

1. Shtojcat e këtij Memorandumi do të jenë pjesë të pandara të tij.
2. Këtij Memorandumi mund t'i bashkëngjiten Shtojca shtesë duke ndjekur procedurën e përshkruar në Nenin 14 të këtij Memorandumi.

Neni 17
Vazhdimësia


1. Dispozitat e Nenit 7 (“Përgjegjësitë dhe zhdëmtimi”), Nenit 9 (“Të drejtat e pronësisë intelektuale”), Nenit 12 (“Zgjidhja e mosmarrëveshjeve”) dhe Nenit 13 (“Privilegjet dhe imunitetet”) do t'i mbijetojnë ndërprerjes ose përfundimit të afatit të këtij Memorandumi.

Neni 18
Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

1. Ky Memorandum do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të fundit të vendosur nga Palët dhe do të mbetet i vlefshëm derisa të përfundojë me shkrim sipas Nenit 15 të Memorandumit.

Ky Memorandum hartohet në 2 (dy) ekzemplarë origjinalë në gjuhën angleze, një kopje për secilën Palë. Në shenjë respekti, ofrohet një përkthim në shqip i Memorandumit. Në rast mosmarrëveshjeje për interpretimin e dispozitave të këtij Memorandumi, përparësi do të ketë versioni në gjuhën angleze.

**Për Prezencën e OSBE-së në
Shqipëri**



Ambasadori Vincenzo Del Monaco
Kreu i Prezencës

Data: 14.04.2021

**Për Gjykatën Kushtetuese të
Shqipërisë**



Znj. Vitore Tusha
Kryetare



Data: 14.04.2021

Shtojca 1

Mbështetje për Gjykatën Kushtetuese përmes seminareve trajnuese profesionale

Gjatë vitit 2021, në kuadër të Projektit me titull “Mbështetje për forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri”, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri (“Prezenca”) planifikon të mbështesë Gjykatën Kushtetuese përmes seminareve trajnuese profesionale si një nevojë e identifikuar nga draft Strategjia 2021-2023 dhe plani i saj i veprimit. Këto veprimtari vijnë në kushtet kur Gjykata tashmë është plotësuar me anëtarë të rinj dhe disa këshilltarë të sapoemëruar.

Duke pasur këtë në fokus, Prezenca planifikon të organizojë dy seminare trajnuese dy-ditore me Gjykatën. Seminari i parë trajnues do të organizohet me gjyqtarët anëtarë të Gjykatës dhe do të trajtojë temën “Juridiksioni kushtetues dhe juridiksioni gjyqësor, vija ndarëse e tyre- Si krijohen, zhvillohen dhe ndryshohen standardet kushtetuese në aspektin procedural”.

Seminari i dytë trajnues do të zhvillohet me këshilltarët ligjorë të Gjykatës mbi kompetencat e reja të Gjykatës sa i takon “Ankimit kushtetues individual”. Veprimtaria do të ketë në fokus funksionet institucionale të këshilltarëve ligjorë të Gjykatës gjatë shqyrtimit të ankimit kushtetues individual, për një këshillim efektiv të anëtarëve të Gjykatës për zgjidhjen e ankimit.

Shpenzimet organizative për të dy aktivitetet do të mbulohen nga Prezenca në partneritet me Konrad Adenauer Stiftung, përmes një marrëveshje të detajuar mes dy partnerëve.

Në varësi të situatës së kushtëzuar nga pandemia, Prezenca do të bëjë përpjekje për t'i zhvilluar këto aktivitete me praninë fizike të pjesëmarrësve ose në një format hibrid në gjysmën e dytë të vitit. Nëse situata ende nuk do ta lejojë, ato do të zhvillohen on-line.¹

Me qëllim që të sigurohet cilësia dhe dobishmëria e seminareve trajnuese, për përgatitjen dhe realizimin e tyre, Prezenca do të konsultohet ngushtë me Gjykatën lidhur me përmbajtjen e diskutimeve, në mënyrë që të mbulohen nevojat e të gjitha palëve dhe veprimtaritë të realizohen me sukses. Prezenca do të sigurojë të gjitha kushtet për zhvillimin e veprimtarive dhe Gjykata Kushtetuese do të mundësojë praninë e pjesëmarrësve në këto veprimtari.

Trajnerë ndërkombëtarë dhe/ose vendas me ekspertizën përkatëse të temave të trajtuara do të kontraktohen nga organizatorët për të kontribuar në hartimin e modulit të seminareve trajnuese dhe për të marrë pjesë në cilësinë e trajnerit. Ekspertët ndërkombëtarë do të zgjidhen mundësisht nga juridiksioni kushtetues gjerman, duke pasur parasysh ngjashmëritë me atë vendas. Në rast se kufizimet e vendosura nga pandemia do të përbëjnë një pengesë, ekspertët ndërkombëtarë do të japin kontributet e tyre përmes komunikimit on-line. Organizatorët gjithashtu do të ofrojnë përkthimin nga gjermanishtja në shqip dhe anasjelltas. Për këtë qëllim, do të kontraktohen përkthyes të cilët do të ndihmojnë me përkthim gjatë aktiviteteve si dhe me përkthim të materialeve trajnuese.

¹ Shpenzimet për aktivitetet e zhvilluara me praninë fizike të pjesëmarrësve do të jenë të tilla si qiraja e sallës së konferencave, tarifat e trajnerëve, tarifat dhe pajisjet e përkthimit, pushimet e drekës dhe kafesë, etj.